

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Projektligji ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”’.

Ministria e Brendshme fton qytetarë, prefektët e qarqeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqatat e bashkive, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të Projektligji ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut”’.

Ministria e Brendshme mirëpret:

- Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e rolit të prefektit të qarkut, për përgjegjësi konkrete për bashkërendimin dhe koordinimin e bashkëpunimit të pushtetit vendor dhe institucionet qendrore në nivel vendor.
- Komente nga cilido që mund të njohë fushën e pushtetit vendor dhe bashkëpunimit të prefektit të qarkut me pushtetit vendor dhe institucionet qendrore në nivel vendor.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektvendimit. Zyra e Ministrisë së Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në aktin e përmendur dhe në rast se sugjerimet nuk reflektohen në projektvendim.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 1 muaj, nëpërmjet publikimit në RENJK, nga data 26 tetor 2023 deri më 26 nëntor 2023.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrit Elektronik për projektaktit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>.
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Me shkresa zyrtare nga ministritë e linjës.

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe /ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail Sara.Shameti@mb.gov.al

Z. Arben Xhaferi – Drejtor, Drejtoria e Politikave të Çështjeve Vendore, e-mail Arben.Xhaferi@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Duke filluar nga muaji prill i vitit 2023 ka filluar puna për identifikimin e grupeve të interesit, përcaktimit të metodave të konsultimit dhe janë zhvilluar disa takime të grupit të punës.

- Në zbatim të urdhrat të Ministrit të Brendshëm me nr. 58, datë 28.04.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut””, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe konsolidimin e performancës së prefektit të qarkut, është ngritur grupi i punës dhe takimi i parë i tij është zhvilluar me datë 31 gusht 2023 në ambientet e Ministrisë së Brendshme.
- Në datë 25 shtator 2023 akti ka kaluar për mendim nëpërmjet sistemit të e-akteve tek Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
- Gjithashtu, është dërguar për mendim nëpërmjet emailit të datës 15 shtator 2023 pranë Shoqatës për Autonomi Vendore dhe Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë.
- Projektligji është dërguar për mendim nëpërmjet emailit të datës 12 shtator 2023 pranë Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, por edhe për përfshirjen në mbledhjen e radhës së Këshillit Konsultativ, duke qenë në rolin e Sekretariatit Teknik të këtij këshilli.

Sfondi i propozimit legjislativ

Domosdoshmëria e ndryshimeve ligjore, për ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut” ka lindur si nevojë për të rritur efikasitetin dhe konsolidimin e performancës së prefektit të qarkut, për ofrimin e shërbimeve më cilësore, për një qeverisje gjithmonë e më pranë qytetarëve, si dhe përfundimit të rolit të tij në qark.

Propozimet

Qëllimi i këtij projektligji është përfundimin e rolit të prefektit të qarkut, misionit dhe kompetencave në përmbushje të detyrave të tij, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qark. Domosdoshmëria e ndryshimeve ligjore, për ligjin nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”

ka lindur si nevojë për të rritur eficienten dhe konsolidimin e performancës së prefektit të qarkut, për ofrimin e shërbimeve me cilësore për një qeverisje gjithmonë e më pranë qytetareve, si dhe përforcimit të rolit tij në qark.

Për vetë rolin e rëndësishëm që ka prefekti i qarkut, si një nga institucionet kryesore, të cilës legjislacioni në fuqi i ngarkon përgjegjësi konkrete për bashkërendimin dhe koordinimin e bashkëpunimit të pushtetit vendor dhe institucionet qendrore në nivel vendor, këto rregullime të veçanta janë të domosdoshme. Pikërisht, ky projektligj do të garantojë përmirësimin e funksionimit të institucionit të prefektit të qarkut, duke forcuar rolin e tij në qark, pasi është i vetmi institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projekt-ligjit të propozuar.

- Si e vlerësoni përgjegjësinë që i shtohet Prefektit të Qarkut mbi monitorimin e zbatimit të projekteve, programeve sektoriale në qark, që zhvillohen me fonde të kushtëzuara apo fonde të qeverisë qendrore, veçanërisht për sa i përket respektimit të afatave dhe cilësisë?
- Çfarë mendoni në lidhje me përgjegjësitë e shtuar sipas këtij ligji, ku Prefekti i Qarkut për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi, thërret ekspertë të jashtëm të fushës përkatëse për të cilën nevojitet ekspertiza?